



ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTIKORRUPSION
DHE DINJITET – ÇOHU!

ANALIZË E PAKOS SË AHTISAARIT

SHKURT 2007

Rruga "UÇK" 105, Kati III/7 Prishtinë
E-mail: organizatacohu@yahoo.com
Website: www.cohu.org

Hyrje

Kjo analizë e Propozimit Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Dokumenti i Ahtisaarit) do të zbërthejë Dokumentin duke u nisur nga premiset që dalin nga anekset dhe nenet e Dokumentit për të argumentuar se vlerësimet dhe qëndrimet e Grupit Negociator të Kosovës (GN) janë më shumë dëshira të pabazuara dhe interpretime të lira sesa studim real i substancës së Dokumentit të Ahtisaarit. Në përgjithësi Dokumenti i Ahtisaarit legjitimon strukturat paralele të serbëve në Kosovë, legjitimon prezencën e Serbisë në Kosovë dhe u jep shtytje kërkesave separatiste të tyre. Së pari, propozimi krijon mundësinë për komunat serbe që të krijojnë një lloj entiteti të pavarur nëpërmjet një organi ndërkomunal me të drejtë vendim-marrjeje duke krijuar një nivel të mesëm qeverisjeje dhe, së dyti, krijon mundësinë e lidhjes institucionale të këtij entiteti me shtetin serb duke anashkaluar institucionet qendrore kosovare. Kështu në Kosovë me këtë dokument po krijohet entiteti serb i cili nuk është i lidhur me Prishtinën si qendrën e tij, ku ekziston një mungesë e theksuar e subordinimit të njërive lokale të pushtetit ndaj qendrës, gjë që krijon kushte për krijimin e një entiteti serb me mundësi të lidhjes direkte me Serbi. Poashtu, çështja e mohimit të sovranitetit të Serbisë është një gjë që nuk mund të konstatohet nga Dokumenti, por edhe nuk ka ndonjë dispozitë që domosdoshmërisht çon drejt pavarësisë së plotë të Kosovës.

Sovraniteti i dyfisht

Argumenti kryesor i Grupit Negociator në favor të pakos së Ahtisaarit ka qenë fjalia se “me këtë pako hiqet sovraniteti i Serbisë mbi Kosovën”. Nocioni i sovranitetit shumë shpesh është thjeshtuar dhe keqinterpretuar nga politikanët kosovarë, të cilët për gjithë kohën e negociatave nuk luajtën rolin e përfaqësuesve të Kosovës por më shumë u shfaqën si përfaqësues të UNOSEK-ut dhe Ahtisaarit për marrëdhënie me publikun kosovar. Pra, brenga e tyre ishte krijimi i një opinionit pozitiv për procesin e negociimeve, një proces tërësisht jotransparent dhe jodemokratik, dhe kështu GN në shumicën e rasteve ka shtrembëruar shumë fakte prej të cilave më kryesori është shtrembërimi i nocionit pavarësi dhe sovranitet.

Grupi Negociator ka pohuar në vazhdimësi se dokumenti i Ahtisaarit nuk e njeh sovranitetin e Serbisë mbi Kosovë dhe kur ka përmendur këtë ka argumentuar me faktin se në këtë dokument nuk është përmendur sovraniteti serb, sikundër që është përmendur në Rezolutën 1244 dhe në dokumentet tjera që i kanë paraprirë kësaj rezolute. Argumenti i parë që mund të përdoret kundër këtij konstatimi eluziv natyrisht është fakti se mospërmendja e sovranitetit serb nuk është domosdoshmërisht mohim i këtij sovraniteti. Nuk mund të ketë një vend pa sovranitet, por vetëm mund të ketë vend me sovranitet ose me sovranitet të dyfisht. Për t’ia mohuar sovranitetin një vendi ndaj një territori duhet pohuar sovranitetin e një vendi ose autoriteti tjetër ndaj po të njëjtit territor, ose duhet pranuar sovraniteti i dyfisht. Kjo ka ngelur krejtësisht e pasqaruar me Pakon e Ahtisaarit, çfarë krijon paqartësi dhe pasiguri në lidhje me status.

Përveç interpretimit euforik të GN-së rreth supozimit për mohimin e sovranitetit të Serbisë mbi Kosovën në vazhdimësi është bërë edhe një interpretim tepër i ngusht i sovranitetit si koncept. Shumë shpesh sovraniteti është kuptuar vetëm si e drejtë e Kosovës për të aplikuar në organizma ndërkombëtare, për të pasur disa organe qendrore,

një gjysëm-ushtri të veten si dhe ndonjë element që në të vërtetë janë pjesë e sovranitetit por që në asnjë mënyrë nuk përbëjnë tërësinë e sovranitetit të një vendi të pavarur. Përveç këtyre elementeve, sovraniteti përfshinë edhe aftësinë e shtetit për të ushtruar pushtetin e vet në tërë territorin e tij. Në qoftë se organet qendrore si Gjykata Supreme, Kuvendi apo Administrata Tatimore nuk janë në gjendje të ushtrojnë autoritetin e tyre në tërë territorin e Kosovës, atëherë ai vend nuk mund të pretendojë se ka sovranitet dhe, për më keq, nuk mund të funksionojë lirshëm si një territor kompakt.¹ Bartësi i këtij pushteti në aspektet më kryesore të rregullimit të jetës publike, siç janë për shembull aspektet më të rëndësishme si mbrojtja e rendit, ligjit dhe sigurisë, definimi i njësive lokale të pushtetit dhe i kompetencave të tyre, duhet të jetë një organ qendror ligjvënës, i cili në vendet me sistem parlamentar siç pretendon të jetë Kosova, është Parlamenti. Pushteti i një shteti nuk përbën asgjë veçse zbatimin e vendimeve të ligjvënësit dhe ekzekutivit në një linjë subordinuese drejt njësive më të ulëta të pushtetit. Vendimet merren me shumicë votash dhe nga ligjvënësi kalojnë tek organet ekzekutuese për zbatim. Kjo aftësi është mohuar në një masë të konsiderueshme me Dokumentin e Ahtisaarit duke qenë se ligjvënësi nuk ka mundësi të vendosë me shumicë votash për një sërë çështjesh në lidhje me komunat, të cilat çështje praktikisht kanë të bëjnë me sovranitetin e shtetit. Këto çështje kërkojnë edhe shumicën e votave të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Çështja komplikohet kur kemi parasysh sesi janë zhvilluar marrëdhëniet në Kosovë në shtatë vitet e fundit në trekëndëshin shqiptarë-serbë-ndërkombëtarë. Për tërë këto vite administrimi ndërkombëtar nuk është arritur integrimi i pakicës serbe në jetën publike dhe institucionale në Kosovë. Nuk ka asnjë arsye apo argument shtesë që tregojnë se pakica serbe do integrohet në institucionet kosovare nesër. Kuptohet që një pjesë të fajit për mosintegrim bartin shqiptarët si popull shumicë në Kosovë, mirëpo aspak më të pafajshëm në këtë drejtim nuk janë Serbia dhe UNMIK-u. Edhe kur ka pas qëllime të sinqerta të integritetit të tyre, Serbia ka bërë ç'mos që serbët lokal të mos integrohen në institucione duke i kërcënuar me ndërprerje të pagave apo të neutralizimit politik të ndonjë lideri serb lokal. Duke manipuluar me serbët lokal Serbia ka arritur që të imponohet si lojtar kyç në Kosovë dhe në zgjidhjen e problemit të saj. Në të njëjtën kohë, UNMIK-u për të mos dështuar si mision ka ushtruar presion mbi palën shqiptare, si palë më e dobët, për të integruar serbët dhe ka pranuar pothuajse çdo kërkesë të Serbisë. Në këtë mënyrë është krijuar një situatë ku Serbia ka arritur që të kthejë autoritetin dhe sovranitetin e saj në pjesë të Kosovës, kryesisht të banuar me serbë. Dokumenti i Ahtisaarit ia njeh Serbisë këtë të drejtë duke pranuar realitetin në terren dhe nëse miratohet ky dokument në Këshill të Sigurimit të OKB-së dhe Kosovës i njihet pavarësia nga shtetet veç e veç, atëherë realiteti në terren do të jetë ai i sovranitetit të dyfishtë mbi Kosovën, nga Serbia dhe vetë Kosova.

Pikat kontestuese të Ahtisaarit

Janë disa pika në Dokumentin e Ahtisaarit të cilat Grupi Negociator i Kosovës do duhej t'i kontestonte dhe të kërkonte rishikim të tyre apo edhe t'i refuzoj sepse këto pika i mundësojnë Serbisë që të pengojë funksionimin e rrjedhshëm dhe normal të

¹ Shih raportin e Organizatës ÇOHU! "Korrupsioni dhe Krimi i Organizuar: Reflektimi në Negociatat për Status"

<http://www.cohu.org>

institucioneve të Kosovës. Siç u tha edhe më lart, bazuar në këto shtatë vite administrimi ndërkombëtar por edhe të përvojave të mëhershme të Kosovës me Serbinë, ajo do të mundohet që të dëshmojë me çdo kusht se intervenimi ndërkombëtar në Kosovë ka qenë gabim, se pëlqimi i Serbisë për çfarëdo që ndodh në Kosovë është parakusht për sukses, se shqiptarët janë të paaftë për shtet dhe mbrojtje të pakicave, etj. Për të shmangur vazhdimin e status-kuos dhe për të mos ia lejuar Serbisë mbajtjen e Kosovës peng të saj, GN duhet të kontestojë dhe refuzojë pikat që dëmtojnë funksionimin e Kosovës si shtet normal.

1. Decentralizimi

Pika 3.7, a), e Aneksit I të Dokumentit të Ahtisaarit thotë se votat e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë kërkohen për ligjet që ndryshojnë kufinjt e komunave, themelimin ose shpërbërjen e komunave, definimin e fuqisë së komunave dhe të participimit të tyre në bashkëpunim ndërkomunal dhe jashtë kufijve të vendit. Në asnjërën nga këto fusha ligjvënësi i Kosovës nuk mund të merr vendim me shumicë votash, por i duhet domosdoshmërisht vota e dy të tretave të pakicave. Kjo qartazi paraqet një mohim të sovranitetit të Kosovës ndaj territorit të vet duke qenë se organet qendrore nuk kanë mundësi kontrolli ndaj njërive lokale qeverisëse jo vetëm në raporte të brendshme, por as në raporte jashta vendit. Në anën tjetër, duke pasur parasysh praktikat e deritashme të komunave serbe në Kosovë posaçërisht faktin se këto komuna dhe përgjithësisht komuniteti serb në Kosovë janë subordinuar kryesisht ndaj Beogradit, është krejtësisht e logjikshme se sovraniteti në Kosovë do të ndahet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Praktikata e deritashme tregojnë se serbët do të vazhdojnë të qeverisin në mënyrë të njëanshme në komunat që u përkasin, ndërsa në ligjvënësin e Kosovës do të kthehen herëpashere eventualisht për të zhbllokuar ndonjë vendim që është në favor të tyre, ndërkohë që do të sabotojnë dhe bojkotojnë të gjitha ato që nuk iu interesojnë. Për më shumë, në dokument nuk specifikohet çfarë ndodh kur në kuvend nuk arrihet kuota e nevojshme e dy të tretave të votave të komuniteteve joshqiptare për të kaluar një ligj. A mos do të thotë kjo se një ligj mund të bllokohet në pafundësi?

Këto veprime në raport me organet qendrore të Kosovës në të kaluarën serbët e Kosovës i kanë bashkërenduar me autoritetin e Beogradit dhe nuk ka arsye të besohet se kjo praktikë nuk do të vazhdohet. Në këtë formë praktikisht Beogradi do të ketë mundësi direkte në ushtrimin e pushtetit të tij në Kosovë, kështu që një pjesë e mirë e pushtetit në Kosovë do të ndahet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Nëse kjo është kështu, atëherë pohimi i GN-së se është mohuar sovraniteti serb në Kosovë nuk është i vërtetë.

Sa i përket integritetit të serbëve lokal në Kosovë, dispozitat e Dokumentit të Ahtisaarit, në krahasim me ato të Kornizës Kushtetuese, në të vërtetë i keqsojnë prospektet për integritet të territorit të Kosovës dhe krijojnë mundësi për krijimin e një entiteti të pavarur serb me mundësi të lidhjes direkte me Serbinë. Pika 9.1.2, Aneksi III, u jep mundësinë komunave që të krijojnë organe partneriteti me të drejt vendimmarrjeje. Kjo në praktikë shumë lehtë mund të shndërrohet në një entitet. Vendimet dhe aktivitetet e këtyre entiteteve duhet vetëm të raportohen tek autoritetet qendrore, ndërkohë që autoriteti qendror nuk ka ndonjë mekanizëm për të parandaluar ndonjë veprim kundërkushtetues të komunave dhe këtyre partneriteteve-entiteteve. Në anën tjetër, pika 10.1 e po këtij Aneksi

krijon mundësinë për entitetin serb që të krijojë lidhje direkte me shtetin serb. Të gjitha këto vendime dhe marrëdhënie mund të krijohen pavarësisht nga pushteti qendror dhe kjo natyrisht përbën një fakt shtesë për mundësinë e ushtrimit të sovranitetit serb në Kosovë. Mbi këto aktivitete dhe mbi pranimin e ndihmave financiare nga Serbia, është paraparë vetëm njoftimi i Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe jo ndonjë lloj leje për këtë. Për ndihmat financiare komunat nuk kanë ndonjë obligim t'i raportojnë pushtetit qendror, por vetëm asambleve të tyre komunale.

Këtu faktikisht është krijuar ai niveli i tretë apo i mesëm i qeverisjes që GN në mënyrë të pandërprerë e ka mohuar. Po ofrohet mundësia që të krijohet një entitet i pavarur serb i lidhur për institucionet qendrore kosovare me fije të holla por shumë fuqimisht i lidhur me Serbinë.

2. Certifikimi i Kushtetutës

Kushtetuta është akti themelor për rregullimin e një shteti. Zakonisht kushtetuta është produkt i një plebishiti (plebiscite) ose referendumi. Në tërë botën demokratike kushtetuta miratohet nga populli në referendum; kjo bile ndodh edhe në vendet totalitare qoftë edhe sa për sy e faqe. Me dokumentin e Ahtisaarit, kosovarët jo vetëm se nuk do të kenë mundësinë të vendosin për kushtetutën e tyre me referendum, por as me shumicën e votave të përfaqësuesve të tyre. Kushtetuta e ardhshme e Kosovës duhet të certifikohet nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) dhe mëpastaj vetëm formalisht të miratohet nga Kuvendi i Kosovës. Përveç kësaj, Dokumenti i Ahtisaarit përcakton se në rast se ka ndonjë konflikt mes dokumentit të tij dhe Kushtetutës së ardhshme të Kosovës, Dokumenti i Ahtisaarit do të sundojë mbi Kushtetutën. Akoma më e komplikuar bëhet çështja kur i shton kësaj edhe pikën 10.1 të Aneksit I, që praktikisht pamundëson amandamentimin e Kushtetutës nga Kuvendi i Kosovës përveç në rastin kur për këtë ekziston edhe vullneti i komuniteteve që nuk i takojnë shumicës.

Dmth, këtu po bëhet një shkelje e dyfishtë e vullnetit të popullit shumicë: njëherë duke injoruar tërësisht vullnetin e tij për një dokument që i rregullon dhe i përcakton të drejtat dhe obligimet e tij ndërqytetare dhe karshi institucioneve të vendit dhe, herën e dytë, duke e bërë një shumicë prej 90 përqind të varur, për të mos thënë peng, nga pakicat që përbëjnë vetëm 10 përqind të popullsisë së përgjithshme. Mos-hedhja në referendum e kushtetutes është shumë shqetësuese për të ardhmen e këtij vendi dhe për të ardhmen e demokracisë në këtë vend. Nëse ndërkombëtarët shkelin parimet elementare të demokracisë atëherë çfarë mund të pritet nga politikanët kosovarë të cilët do duhej të mësonin nga këta ndërkombëtarë, sidomos kur misioni ndërkombëtar është këtu për të na mbikqyrur në rrugën tonë drejt konsolidimit të “demokracisë” dhe “sundimit të ligjit”. Kjo mënyrë e miratimit të kushtetutës është vetëm edhe një indikator se status-kuoja do vazhdojë në Kosovë sepse të rikujton miratimin e Kornizës Kushtetuese. Për më shumë, kjo simbolizon tërë procesin negociator i cili është përcjellë me një mungesë të plotë transparence dhe mosmarrje parasysh të interesave të popullatës shumicë, gjë që paraqet edhe një shkelje të rëndë të parimit më elementar të demokracisë.

3. Drejtësia

Nga Dokumenti i Ahtisaarit, gjegjësisht Pika 1.3 e Aneksit IV, shifet se gjasat janë reale të krijohen gjykata të reja për komuna të reja me shumicë serbe. Kjo do të thotë se është shumë i mundur edhe një riorganizim i gjykatave në atë mënyrë që sipas të gjitha gjasave mund të krijohen edhe një ose më shumë gjykata të qarkut për rajonet me shumicë serbe. Në këtë kontekst, pika 1.2 e Aneksit IV jo vetëm që del absurde, por edhe krijon një rrezik të madh të humbjes së mundësisë për të kontrolluar ligjshmërinë e vendimeve të organeve për partneritet të komunave dhe të vetë komunave për arsyen që vijon:

Pika 1.2 e Aneksit IV përcakton që 15% ose së paku dy gjyqtarë të secilës gjykatë të qarkut duhet të jenë nga komunitetet që nuk e përbëjnë shumicën në Kosovë. Kjo praktikisht do të thotë se gjyqtarë nga pakicat do të ketë edhe në ato gjykata të qarkut ku nuk ka serbë fare ose numri i tyre është i papërfillshëm, por në anën tjetër krijon mundësinë që ndonjë gjykatë e qarkut të mos ketë asnjë gjyqtar nga komuniteti shumicë, pra ai shqiptar. Çka do të thotë kjo kur ndërlidhet me pikën 10.4 të Aneksit III mbi decentralizimin?

Pika 10.4 Aneksi III parashef se vendimet e komunave apo të organeve për partneritet të komunave mund të rishikohen nga Ministria e Pushtetit Lokal për të parë nëse këto vendime janë në pajtim me kornizën qendrore ligjore. Sipas po të njëjtës pikë Ministria mund të suspendojë ndonjë vendim për kooperim (me shtetin Serb v.j.) në rast se ndonjë thyerje serioze e ligjit nuk mund të riparohet ndryshe. Këtë vendim për suspendim komuna mund ta apelojë në Gjykatën komunale nën jurisdiksionin e së cilës gjendet komuna në fjalë. Duke marrë parasysh se Pika 1.2 e Aneksit IV nuk obligon gjykatat e qarkut që patjetër të ketë gjyqtar nga shumica shqiptare, mund të ndodhë fare lehtë që ankesën e një komune serbe ta shqyrtojë një gjykatë krejtësisht serbe. Në këtë rast praktikisht pushteti i qeverisë qendrore do të mbaronte këtu.

Ajo që komplikon akoma më shumë këtë fushë është fakti se Rregullorja 2006/18 mbi Kornizën e Sistemit gjyqësor nuk do të ndryshojë dhe as nuk do të shfuqizohet as pas përfundimit të mandatit të UNMIK-ut dhe as pas futjes në fuqi të Kushtetutës së ardhshme të Kosovës.

4. Strukturat e sigurisë

Dokumenti i Ahtisaarit nuk parasheh formimin e një ushtrie për Kosovën. Interpretimi i GN-së se Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK) është një ushtri e ardhshme kosovare është, si edhe shumë interpretime tjera të Dokumentit, më shumë një dëshirë sesa një aspiratë e bazuar në kornizën për statusin e ardhshëm. Pika 5.2 e Aneksit VIII përcakton që KSF duhet të ketë vetëm 2,500 pjesarë dhe të jetë e armatosur me armë të lehta, pa armë të rënda siç janë tankset, artileria ose aftësi tjera ofanzive. Të gjitha pikat e Artikullit 5 të Aneksit VIII e përcaktojnë KSF-në me një fizionomi dhe mision krejtësisht të njëjtë me TMK-në. Në anën tjetër, është caktuar që TMK-ja të shpërbëhet në një afat prej një viti që nga hyrja në fuqi e Dokumentit të Ahtisaarit. Ky është krejtësisht reflektim i kërkesave serbe për mospërfshirjen e strukturave të ish-UÇK-së në asnjë forcë të sigurisë në Kosovë. Prandaj, edhe deklaratimet e Kryeministrit dhe të GN-së se do të bëhet përfshirja e TMK-së në KSF janë pjesë e demagogjisë dhe e interpretimeve të tyre domosdoshmërisht

pozitive të Dokumentit me qëllim që ta bëjnë të pranueshme për kosovarët. Këtu do duhej shtruar pyetja, nëse u lejuaka përfshirja e pjestarëve të TMK-së në FSK pse nuk ndodhi një transformim i TMK-së në FSK në mënyrë që të plotësohen premtimet që u janë dhënë me vite kosovarëve se TMK-ja është ushtria e ardhshme e Kosovës?

Tutje, është shumë i njëanshëm qëndrimi i Dokumentit të Ahtisaarit që të kërkohet shpërbërja e TMK-së pa sanksionuar strukturat paralele që serbët i krijuan në vendbanimet e tyre, të cilat ata vazhdojnë t'i shohin si forca për sigurinë e vendbanimeve të tyre. Struktura të ashtuquajtura të sigurisë që veprojnë në Mitrovicë të njohura si “Rojet e Urës” që në fakt është MUP-i serb dhe struktura tjera në rajonet tjera të populluara me serbë do duhej të shpërbëheshin me këtë Dokument të Ahtisaarit.

5. Përfaqësuesi ndërkombëtar civil

Aneksi IX i Dokumentit të Ahtisaarit përmbledh të gjitha kompetencat e UNMIK-ut nën ombrellën e Përfaqësuesit Ndërkombëtar Civil (PNC). Në anën tjetër Dokumenti i Ahtisaarit do të jetë një dokument suprem edhe pas futjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës. Sipas pikës 1.1 të Aneksit I, Dokumenti i Ahtisaarit ka superioritet në raport me Kushtetutën e Kosovës. Në anën tjetër autoriteti suprem në Kosovë do të jetë PNC, i cili praktikisht do të shfaqet si një zëvendësim i PSSP-së dhe kompetencat që dalin nga Artikulli 2 i Aneksit IX përfshijnë saktësisht të njëjtat kompetenca sikur PSSP-ja. Asnjë lloj kushtetute e as vendim i institucioneve kosovare nuk mund të ketë efekt mbi kompetencat, autorizimet dhe kohëzgjatjen e PNC. Grupi Drejtues Ndërkombëtar do të vendosë kur duhet të përfundojë mandati i misionit ndërkombëtar në Kosovë dhe për këtë nuk ka asnjë lloj limiti kohor.

Përderisa misioni i ardhshëm ndërkombëtar është i mirëseardhur në fushën e sundimit të ligjit duke pas parasysh se kjo fushë në Kosovë është pothuajse në pikën zero, në anën tjetër, fuqia supreme dhe finale e misionit ndërkombëtar dëmton demokratizimin e Kosovës. Kjo ndodh për dy arsye: një, sepse misioni nuk përqëndrohet në të drejtat e njeriut por në të drejtat e pakicave duke shmangur vëmendjen nga problemet e shumicës dhe, dy, sepse ia mundëson lidhshirë kosovar ashtu sikurse shtatë vitet e fundit që të shfaqësohet për keqmenaxhim për shkak të mungesës së kompetencave.

Konkluzion

Dokumenti i Ahtisaarit ka aspekte pozitive të cilat përmirësojnë jetën e përgjithshme në Kosovë, siç janë e drejta për t'u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare, transferimi i disa kompetencave të UNMIK-ut te organet kosovare dhe, mbi të gjitha, shënon një përparim drejt zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Mirëpo, problemet të cilat u ngritën në këtë analizë të cilat dalin nga Dokumenti i Ahtisaarit vështirësojnë jetën në Kosovë në aspekte tjera, në raste të caktuara duke e bërë edhe më të komplikuar sesa që ka qenë. Funksionimi i lirshëm dhe normal i Kosovës vështirësohet duke legalizuar strukturat paralele serbe të cilat e ruajnë sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën dhe krijojnë një entitet të pavarur serb i cili nuk i jep llogari Prishtinës si qendër të veten por lidhet direkt me Serbinë. Sistemi i vendimmarrjes komplikohet jashtëzakonisht shumë. Në këtë mënyrë Kosovës i pamundësohet funksionimi i rrjedhshëm dhe normal pasi që autoritetet qendrore nuk do të kenë shtrirje në tërë territorin e vendit. Pasqyrë e së ardhmes së

Kosovës me këtë dokument janë shtatë vitet e vështira të status-kuos me UNMIK-un. Grupi Negociator duhet të luftojë për të ndryshuar këto pika për të futur Kosovën me të vërtetë në rrugën e pavarësisë dhe sovranitetit të plotë. Përndryshe Kosova po futet në qorrsohak dhe drejt vazhdimit të status-kuos ashtu sikurse ka ndodhur me Bosnjën që 12 vite pas përfundimit të luftës.